

AKT-THEMELIM
I
SHOQËRISË

BHA sh.p.k.

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901,dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,
UNE, :

**1-Afrim Hoda i biri i Riza-it e datelindjes 23-03-1980, lindur ne Mustafe e banues ne Kukes
i paisur me leternjoftim me Nr.I00323076W.**

Sot me dt. 25/03/2024, me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, vendosa të hartojë këtë Akt-
Themelimi për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **BHA** sh.p.k. si

ORTAKET.

Akti i Themelimit hartohet me këto kushte:

Neni 1

Ortaku , me gjeneralitetet e mësipërme, me vullnet të lirë dhe të plotë krijoj Shoqërinë me
Përgjegjësi të Kufizuar **BHA** sh.p.k. .

Neni 2

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon mënyrën e
organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare dhe në përputhje me dispozitat e Statutit që i
bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi.

Neni 3

Emri i plotë i shoqërisë është **BHA** sh.p.k. .

Neni 4



Selia e shoqërisë është në **Kukes, Lagjia Nr.6, Rruga Avni Rustemi, Pallati Nr.10, Shk Nr.2, Ap Nr.3, Kati I**. Sipas dispozitave të përcaktuara në Statut dhe në Akt – Themelimit, veprimtaria e shoqërisë do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, duke krijuar filialet apo degët e saj.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **BHA** sh.p.k. do të jetë ai i përcaktuar në Statutin e Shoqërisë :

Ndertime civile, projeksion etj. Prodhim dhe tregtim te materialeve inerte, te produkteve te ndryshme prej betoni, si dhe materialeve te ndryshem per ndertim. Punime, prodhim dhe tregtim te materialeve prej duralumini dhe plastike. Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile industriale, veshje fasadash etj. Ndertim rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro etj. Ndertime ujesjellesa, gazsjellesa, vepra kullimi e vaditje, punime dhe mbrojtje lumore sistemim hidraulike dhe bonifikime. Prodhim dhe tregtim i materialev inerte, produkteve te ndryshme prej betoni, si dhe materialeve te ndryshem per ndertim. Punime, prodhim dhe tregetim te materialeve prej duralumini dhe plastike. Punime elektrike dhe tregtim te materialeve elektrike, paisjeve elektrike, matesave elektrike etj. Pervec aktiviteteve te pershkruar me siper, objekt i aktivitetit te shoqerise do te jete cdo veprimtari qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e pershtatshme per shoqerine, e cila nuk ndalohet nga ligji. Ndertime per Nen/stacione, Ndertim Rjeti TL TM TU , Rikonstruksion e rjetit TM TU TL, kabinat e transformatoreve dhe shperndarjen e energjise. Transport Mbetje Inertesh per vete dhe te trete. Veprimtari private në fushën e studimit, projektimit, supervizionit dhe ndërtimin e linjave elektrike të TN, TM, TU mbi tokësore (ajrore) dhe nëntokësore (kabllore) për energji elektrike dhe telekomunikacioni, nënstacionet elektrike TN/TM dhe të tensionit të mesëm TM/TU (kabina elektrike), centrale dhe hidroventralet, rrjete inxhinierike, objekte civile dhe industriale. Realizimin e impianteve të telekomunikacionit. Studim dhe projektim për makineri elektrike dhe të linjave të ndryshme industrial. Mirëmbajtje, remont profilaktik të mesëm e capital të transformatorëve elektrik të çdo lloji, makinave elektrike si dhe paisjeve elektrike. Import-eksport të matrialeve elektrike, telekomunikacionit, sistemeve të alarmit, të vjedhjeve dhe kundra zjarrit, mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, tregtimin e mallrave të gatshëm, etj. Import-eksport.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë **100.000 (njqind mije) leke** ndare ne 1 kuote . Kapitali themeltar mund të rritet sipas dëshirës së ortakut dhe kushteve në të cilat ushtron veprimtarinë, në formën dhe mënyrën e parashikuar në Statut.

Neni 7

Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z. Afrim Hoda** dhe kompetencat e tyre përcaktohen në Statut.

Neni 8

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor, ora 24⁰⁰ te çdo viti kalendarik. Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë përfundohet brenda muajit Mars të vitit të pasardhës.

Neni 9

Shoqëria gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë ti përdorë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 10

Ky Akt-Themelim do të jetë efektiv nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.
Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Për Shoqërinë

BHA shpk

ADMINISTRATORI

Ortaku

Afrim Hoda